



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.962/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Jahir Morina, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Jahir Morina, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 11:35, ka pranuar një apel nga Jahir Morina, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, me të cilin pretendon se gjatë rinumërimit të 88 kutive nga gjithsej 235 kuti ka pasur 14 vota ngritje, ndërsa pa rinumëruar kanë ngelur edhe 147 kuti, andaj kërkon që të rinumërohen edhe kutit tjera të pa rinumëruara në Prishtinë. Si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se, apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit për asnjë VV nuk e ka saktësuar se sa vota i

mungojnë, mirëpo vetëm ka bërë përshkrimin e QV-ve nga FRP-ja dhe në këtë mënyrë nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të dëshmuar pretendimet e tij ankimore në lidhje me mungesën e votave. Prandaj Paneli apelin e saj e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.962/2017 me datën 12.11.2017.



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.